

VENDIM
Nr. 120, datë 31.8.2012

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“PROGRES”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	Kryetare
Sami Nezaj	Zv/kryetar
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar
Suela Musta	anëtare

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Progres”.

BAZA LIGJORE: Nenet 7 pika 21, 34 pika 4/a, 124 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 93, datë 22.6.2012 i KKRT/së “Mbi heqjen e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Progres”

VËREN SE:

Me vendimin nr. 16, datë 28.7.2010, KKRT ka licencuar z. Fatos Senko, person fizik për subjektin televiziv privat kabllor “Progres”, për të mbuluar me sinjal televiziv qytetin e Kavajës dhe komunës Synej. Ky vendim ka hyrë në fuqi në datën 1.9.2010.

Më datë 23.5.2012 grupi i inspektimit të KKRT-së ka kryer inspektim në qytetin e Kavajës, gjatë të cilit është konstatuar se televizioni privat kabllor “Progres” nuk ka filluar të shpërndajë sinjal televiziv. Afati përfundimtar për fillimin e transmetimeve ka qenë data 29.5.2011, afat i cili është shkelur nga ana e subjektit.

Nga ana e inspektorëve të KKRT-së, u konstatua se mungonin pajisjet transmetuese të domosdoshme për daljen në transmetim. Pas komunikimit telefonik me pronarin e televizionit kabllor, ky i fundit ka theksuar se nuk ka dalë në transmetim pasi është penguar nga pushteti lokal për shtrirjen e rrjetit kabllor.

Me vendimin nr. 93, datë 22.6.2012 të KKRT-së “Mbi heqjen e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Progres”, KKRT ka vendosur të njoftojë subjektin e mësipërm për fillimin e procedurave të heqjes së licencës, për shkak të mosdaljes në transmetim.

Ky vendim është nxjerrë në mbështetje të nenit 137/3 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, i cili parashikon se KKRT për ti dhënë mundësi të licencuarit të japë mendime, para marrjes së vendimit për heqjen e licencës, njofton të licencuarin për vendimarrjen përkatëse.

Sipas këtij vendimi, subjektit televiziv kabllor “TV Progres” i është lënë një afat kohor 30-ditor brenda të cilit të paraqesë pretendimet e tij, lidhur me shkeljen e afateve të përcaktuara në ligj për daljen në transmetim.

Në vijim, subjekti privat televiziv kabllor “Progres”, i është drejtuar KKRT-së me anë të shkresës së datës 7.8.2012 me subjekt “Kthim përgjigje”, protokolluar në KKRT me nr. 998/1, datë 8.8.2012, duke parashtruar sa më poshtë vijon:

“...subjekti “TV Progres” me seli në Kavajë fill pas licencimit nga KKRT, në zbatim të rregullores për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimit me kabllor (miratuar me vendim të KKRT nr. 221, datë 30.3.2004) neni 16, ka kërkuar në mënyrë të përsëritur nga pushteti vendor leje për shtrirjen e kabllorëve në qytetin e Kavajës.

Për një periudhë disamujore nuk morëm asnjë përgjigje dhe hasëm pengesa në shtrirjen e rrjetit kabllor nga pushteti vendor. Kjo kërkesë e përsëritur ka gjetur miratimin pranë pushtetit vendor vetëm më datë 28.3.2012 (leje infrastrukture), vonesë e cila argumentohet nga pushteti vendor për shkak të pezullimit të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”.

Pasi morëm miratimin për pajisjen me leje të posaçme ka filluar në mjaft akse të qytetit shtrirja e rrjetit kabllor investime të cilat kapin një shifër të konsiderueshme financiare. Ju njoftojmë gjithashtu se jemi në procesin e testimit të aparaturave teknike dhe në përfundim të testimit konform rregullores do të njoftojmë me shkresë të posaçme institucionin tuaj.

Lidhur me pagesën e detyrimeve brenda një periudhe të shkurtër do të depozitojmë pranë institucionit faturën e cila vërteton pagesën e detyrimeve...”.

Theksojmë se, periudha kohore nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të KKRT-së për dhënie licence, data 1.9.2010 deri në marrjen e lejes për shtrirjen e rrjetit kabllor nga pushteti vendor në datën 28.3.2012, përbën një kohë shumë të gjatë dhe nuk mund të justifikojë mosdaljen në transmetim, duke shkelur edhe limitin e përcaktuar në ligj (270 ditë). Po ashtu, pavarësisht se subjekti pretendon se ka kërkuar në vazhdimësi pajisjen me lejen për shtrirjen e rrjetit kabllor, nuk arrin ta provojë këtë fakt. Për më tepër, gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës, subjekti televiziv privat kabllor “Progres”, nuk ka njoftuar në KKRT për mosplotësimin e kushteve të caktuara në licencë, megjithëse ky është detyrim ligjor.

Kështu, neni 30 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përcakton se: “I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave ... ose për mosplotësimin e kushteve të caktuara në licencë dhe arsyet përkatëse, paraprakisht dhe në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë ...”.

Nga ana tjetër, pavarësisht se në shkresën e mësipërme subjekti ka premtuar shlyerjen e detyrimeve financiare brenda një periudhe shumë të shkurtër, KKRT konstaton se subjekti televiziv privat kabllor “Progres”, nuk e ka shlyer detyrimin financiar, që arrin vlerën 400.000 lekë, pagesë vjetore për licencë për periudhën (vit licencimi) 2011-2012. Afati përfundimtar për kryerjen e pagesës është data 31.8.2012.

Neni 34 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon që Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit kur:

“ ...

4. Nuk ka filluar transmetim pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence për një periudhë kohe:

a) -180 ditë në transmetimet e radios lokale;

- 270 ditë në transmetimet e televizionit lokal;”

Të drejtat dhe detyrimet e televizionit privat kabllor janë të njëjta me ato që parashikohen për televizionin privat vendor (lokal). Konkretisht, neni 124 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, i ndryshuar, i cili përcakton procedurat për marrjen e licencës për transmetim të programeve radiotelevizive kabllore, përcakton se: “Procedura dhe kërkesat e tjera të nevojshme për marrjen e licencës, si dhe të drejtat e detyrimet e subjekteve janë të njëjta me ato që parashikohen për licencat e transmetimeve radiotelevizive në efir të përshkruara në kreun IV të këtij ligji”.

Në përfundim, KKRT konstaton se arsyet e paraqitura nga ana e subjektit televiziv privat kabllor “Progres”, për të justifikuar mosdaljen në transmetim brenda afateve ligjore, nuk janë të mbështetura në ligj e si rrjedhojë nuk mund të merren parasysh,

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit në mbështetje të neneve 7 pika 21, 34 pika 4/a, 124 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 93, datë 22.6.2012 i KKRT-së “Mbi heqjen e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Progres”,

VENDOSI:

1. T’i heqë subjektit person fizik Z.Fatos Senko, licencën për subjektin televiziv privat kabllor “Progres”.

2. Licenca me nr. 081/RTV kabllor e subjektit televiziv privat kabllor “Progres”, bëhet e pavlefshme.

3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijeni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati